

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **24 nëntor 2022** merr këtë:


VENDIM

për pagesën e komisioneve të themeluara nga Kuvendi

1. Me këtë vendim, lejohet kompensimi i anëtarëve të komisioneve të formuara nga kuvendi, që nga data 1.1.2022, deri në hartimin e rregullores për komitetet dhe komisionet e kuvendit.
2. Lartësia e kompensimit për çdo takim caktohet në shumën prej 30€ për anëtar të komisionit, në bazë të procesverbalit për mbajtjen e takimit.
3. Pagesa e anëtarëve të komisioneve mund të bëhet deri në gjashtë (6) takime, për çështjen për të cilën janë formuar, përjashtim bën Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokalë, i cili duhet të paguhet për së paku njëzet e pesë (25) takime.
4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 të këtij vendimi do të merren nga kategoria paga dhe mëditje dhe kategoria e subvencioneve në Zyrën e Kryetarit.
5. Kryesuesi i komisionit obligohet që të dërgojë në Sekretarinë e Kuvendit procesverbalin-raportin e punës lidhur me takimet apo mbledhjet dhe shqyrtimin e çështjeve që janë objekt i punës së komisioneve.
6. Kompensimi i këtyre komisioneve do të bëhet konform legjislacionit në fuqi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
8. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **24 nëntor 2022**, merr këtë:

VENDIM


për miratimin e raportit të vlerësimit vullnetar

1. Me këtë vendim miratohet Raporti i Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë.
2. Qëllimi i miratimit të këtij raporti është qasje në agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara, për të mundësuar lokalizimin e objektivave që lidhen me zhvillimin e gjithmbarshëm të Komunës së Vushtrrisë.
3. Ndër objektivat kryesore të agjendës 2023 të lokalizuara e që mëton t'i zbatojë Komuna e Vushtrrisë janë: zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj; fund-urisë; arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i të ushqyerit; promovimi i bujqësisë së qëndrueshme; sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë, në të gjitha moshat; sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë; të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat; nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme; punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë; si dhe sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe shërbimeve sanitare për të gjithë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij raporti obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01. Nr. 209/2022, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **24 nëntor 2022** merr këtë:

VENDIM

për formimin e komisionit për hartimin e Draft-planit të punës së kuvendit për vitin 2023

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023, në përbërjen si në vijim:

- 1.1. **Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit;**
- 1.2. **Arlind Gogolli, anëtar i kuvendit;**
- 1.3. **Alban Bajrami, anëtar i kuvendit;**
- 1.4. **Nurten Çerkezi-Gjyshinca anëtare e kuvendit;**
- 1.5. **Mensur Kastrati, anëtar i kuvendit.**

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të hartojë draftin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023, dhe të njëjtin duhet t'ia propozojë Kuvendit të komunës për aprovim në mbledhjen e muajit dhjetor 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

